

VENDIM
Nr. 210, datë 28.12.2017

**PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA OST SHA PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të neneve 16; 19, germa “c/i”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 22 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, në lidhje me kërkesën e OST sh.a. për miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, për periudhën 1 janar 2018 – 31 dhjetor 2018,

konstatoi se:

- Bordi e ERE-s, me vendimin nr. 202, datë 5.12.2017, vendosi mbi fillimin e procedurës për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2018.

- ERE, me shkresën nr. 758/2 prot., datë

- 7.12.2017, pas analizës së kryer këtij aplikimi, i kërkoi informacion shtesë OST sh.a., në mënyrë

që kompania të argumentonte më gjerë këtë aplikim dhe që ERE të ishte sa më e drejtë në llogaritjen e kostove që i përkasin OST sh.a. në ushtrimin e aktivitetit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018.

- OST sh.a. iu përgjigj kërkesave për informacion të ERE-s me anë të shkresës nr. 7035, prot., datë 15.12.2017. Pas analizës së përgjigjeve të OST sh.a. u zhvillua një seancë teknike në datën 26.12.2017, me përfaqësues të kompanisë dhe më tej u ra dakord që të dërgoheshin në ERE sqarime të mëtejshme për paqartësitë e lindura në lidhje me analizën e kryer të aplikimit në vetvete dhe, gjithashtu, të përgjigjeve të dërguara nga OST sh.a., të pyetjeve të dërguara nga ERE me anë të shkresave të lartpërmendura.

- Në llogaritjen e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018 OST sh.a. ka llogaritur kostot totale që ajo do të përballojë gjatë gjithë vitit 2018 dhe respektivisht kostot e kapitalit, kostot operative të paraqitura në 4 skenarë të ndryshëm të mundshëm, në varësi të supozimeve për pranimin e komponentëve të ndryshëm, që, për rrjedhojë, rezultojnë në nivele të ndryshme të tarifës mesatare të transmetimit për vitin 2018, duke e lënë në gjykimin e ERE-s pranimin e njërit apo tjetrit komponent apo skenar.

- OST sh.a., në përputhje me vendimin nr. 135, datë 6.9.2017, “Mbi miratimin e rregullores së procedurave të paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike,” të paraqesë planin e investimeve të përditësuar për vitin 2018, i cili do të jetë objekt i vendimmarrjes së bordit, sipas rregullores së procedurave të paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Nga aplikimi vërehet se shoqëria OST sh.a., gjatë vitit 2017, parashikon të shpenzojë 1,165 milionë lekë për prokurimin e humbjeve në rrjet, humbje e cila është vlerësuar me rreth 169 milionë kwh. Nga shoqëria OST sh.a. parashikohet që kjo sasi energjie të blihet në treg dhe parashikohet të blihet me një çmim mesatar prej 50 euro/mwh, bazuar në të dhënat e HUPX-së.

- OST sh.a., në aplikimin e saj për tarifë parashikon që të shpenzojë rreth 500 milionë lekë për pagesa CBT-je për vitin 2017, shumë e cila varet nga marrëdhëniet e shkëmbimit të energjisë me shtetet e tjera. Për llogaritjen e një shpenzimi të tillë OST sh.a. është mbështetur edhe në trendin disaveqar të këtyre lloj pagesave, duke marrë në konsideratë dhe faktin se energjinë për mbulimin e humbjeve do ta prokurojë në treg të parregulluar dhe se rritja e çmimit të prokurimit të humbjeve do

të influencojë direkt në rritjen e pagesave për CBT-në. I qëndrojmë vlerësimit të shoqërisë bazuar në argumentimin e paraqitur nga OST sh.a.

- Në aplikimin për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018, OST sh.a. ka parashikuar një sërë shpenzimesh që lidhen me prokurimin e kapacitetit rregullues dhe atij rezervë për shërbimin e balancimit. Në total këto shpenzime, ku përfshihen kapacitetet rezervë të rregullimit dhe ridispeçerimi kapin shifrën prej 1,233 milionë lekësh, kundrejt 100 milionë lekëve shpenzuar për periudhat paraardhëse.

- Vlera neto e aseteve pasi janë marrë në konsideratë të dhënat faktike të bilancit 2016 arrin në 33,363, realizimi i pritshëm për vitin 2017, sipas raportimeve të fundit me 36,487 milionë lekë krahasuar me 48,747 të cilën e propozon OST sh.a. për vitin 2018.

- Në aplikim theksohet se volumi i transaksioneve të energjisë dhe, si rrjedhojë edhe i kërkesës për kapacitete transmetuese në interkoneksion, nuk është proporcional përgjatë gjithë muajve të vitit dhe se merren parasysh risitë dhe paqartësitë e alokimit të kapaciteteve në interkoneksione nga zyra përkatëse rajonale, CAO në Podgoricë, në parashikimin e të ardhurave që OST sh.a. mund të sigurojë në ankandet e alokimit të kapacitetit në interkoneksion gjatë gjithë vitit 2018, të cilat parashikojnë të jenë rreth 8 milionë euro ose 1,100 milionë lekë dhe që do të sigurohen nga pjesëmarrësit e tregut.

- Nga të dhënat faktike të pasqyrave financiare të viteve 2015, 2016 dhe atyre të pritshme për vitin 2017 rezulton se tarifat faktike respektive të transmetimit për këto vite janë 0,48 lekë/kwh, 0,55 lekë/kwh dhe 0,65 lekë/kwh. Bazuar në këto nivele tarifash është llogaritur efekti në të ardhurat e shoqërisë, duke u reflektuar si axhustim i periudhave të kaluara në llogaritjen e tarifës për vitin 2018 në zbritje për vlerat 1,172 milionë lekë, 637 milionë lekë dhe 31 milionë lekë, si të ardhura të tepërta, përkatësisht për vitet 2015, 2016 dhe 2017, kundrejt tarifës së miratuar prej 0,65 lekë/kwh për këto vite.

- Nga sa shpjeguar dhe evidentuar në tabelë si më sipër, rezultatja e të gjithë komponentëve të të ardhurave të kërkuara për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018 llogaritet në një vlerë totale prej 5,391 milionë lekësh dhe tarifa mesatare e transmetimit e llogaritur për sasinë (7,231 gwh) që parashikohet të livrohet në rrjetin e transmetimit rezulton 0.75 lekë/kwh.

- Duke qenë se procedura për shqyrtimin e aplikimit dhe analiza e informacionit shtesë dhe e sqarimeve përkatëse, kërkon kohën e saj, ndërkohë që aplikimi nga ana e OST sh.a. është tejet i vonuar, në lidhje me OPEX dhe CAPEX në tërësi, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtyre shpenzimeve, në periudhat e ardhshme kundrejt vlerave reale të tyre.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a., për vitin 2018, të jetë 0,75 lekë/kwh.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti